

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (në vijim ART), me seli në rrugën 'Pashko Vasa' Nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga _____, si themeluese e Njës Shkëmbyese të Internetit (KOSIX)

Në njërën anë dhe

_____ (në vijim _____) me seli në rrugën '_____' _____, Kosovë, përfaqësuar nga _____, i cili përfaqëson anëtarin e KOSIX dhe shfrytëzon shërbimet e KOSIX,

Në anën tjetër.

Në tekstin e mëtejme të referuara bashkërisht si 'Palët' dhe individualisht si 'Pala'

Bazuar në nenin 4.9 të Rregullores për Operimin e Njës Shkëmbyese të Internetit KOSIX (ART Nr. Prot. 046/B/11), më datë; 13/09/2011 kanë lidhur këtë:

**KONTRATË PËR ANTARËSIM
DHE
PËRDORIM TË SHËRBIMEVE TË KOSIX-it
(Nr. Prot. _____)**

**Neni 1
Dispozitat e përgjithshme**

- 1) Me këtë Kontratë, palët përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella lidhur me anëtarësimin në KOSIX dhe përdorimin e shërbimeve të KOSIX-it. Të gjitha këto janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në "Rregulloren për Operimin e Njës Shkëmbyese të Internetit KOSIX", të datës; 13/09/2011, e protokolluar në ART me Nr. Prot. 046/B/11 (tutje e njohur si - Rregullorja e KOSIX ose shkurt Rregullorja);
- 2) Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, do të konsiderohet që anëtari i KOSIX-it është i njoftuar me të gjitha dispozitat e Rregullores dhe pajtohet se këto dispozita janë ligjërisht të detyrueshme për anëtarin e KOSIX-it, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij;
- 3) Me rastin e ndryshimit të Rregullores, palët kontraktuese bien dakord, që ndryshimet do të përfshihen në Kontratën e anëtarësimit (tutje e njohur si - Kontratë). Anëtari i KOSIX-it ka të drejtë që ta ndërpres Kontratën, në përputhje me nenin 7.1.1 të Rregullores.

Neni 2

Shërbimet e KOSIX-it

- 1) KOSIX është i obliguar që anëtarëve të vet t'ju ofroj shërbimet të përshkruara në mënyrë të detajuar në nenin 5 të Rregullores, nën kushte të barabarta dhe në përputhje me dispozitat e rregullores në fjale.
- 2) KOSIX do t'i ofroj anëtarit shërbimet si be vijim:
 - i. Qasjes në KOSIX në përputhje me nenet 3.4 dhe 3.6 të kësaj rregulloreje.
 - ii. Vendosijes së kufizuar të pajisjeve të anëtarëve të KOSIX
 - iii. Mirëmbajtjen e shërbimeve të KOSIX
 - iv. Mbështetjes teknike të anëtarëve të KOSIX
 - v. Raportimit rreth punës së KOSIX

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit

- 1) Anëtari i KOSIX-it obligohet që në përputhje me dispozitat e Rregullores, respektivisht Nenit 8, të përmbush detyrimet, të cilat për anëtarët e KOSIX-it;
- 2) Anëtari i KOSIX-it obligohet që në afatin kohor prej 90 ditësh nga dita e nënshkrimit të Kontratës, të bëjë lidhjen në KOSIX, përndryshe Kontrata do të ndërpritet pa obligim për njoftim paraprak nga ana e ART-së;
- 3) Në rast të mospërmbushjes së obligimeve nga ana e anëtarit të KOSIX-it të përcaktuara në Rregullore, si dhe mos-respektimit të dispozitave të kësaj Kontrate, atëherë ART mund të ndërpresë këtë Kontratë, ku me këtë rast të gjitha pasojat ligjore i bart anëtari i KOSIX-it.
- 4) Anëtari, i cili përdor shërbimet e KOSIX-it, është përgjegjës për veprimtarinë e tij të përgjithshme, të cilën e kryen përmes KOSIX-it e në përputhje me dispozitat e Rregullores, përderisa KOSIX nuk bartë asnjë përgjegjësi;
- 5) Anëtari i KOSIX-it gjatë përdorimit të shërbimeve të KOSIX-it, obligohet që të veprojë në përputhje me normat e internetit, të bazuar në praktika të mira, e cila para së gjithash nënkupton mos shkaktimin e dëmeve ndaj te tjerëve, e në veçanti anëtarëve të tjerë të KOSIX-it;
- 6) Në rast se dëmet e shkaktuara në pajisjet e KOSIX janë si rezultat i pajisjeve të ndonjë anëtarit dhe/ose të personave teknik të autorizuar nga po i njëjti anëtar, atëherë anëtari në fjalë është përgjegjës për kompensim të dëmeve;
- 7) Anëtari ka përgjegjësinë që të garantoj se pajisjet e instaluar në hapësirën e KOSIX-it plotësisht ju përgjigjen standardeve teknike në Republikën e Kosovës. Këto pajisje në asnjë mënyrë nuk duhet të dëmtojnë shëndetin e të punësuarve, vizitorëve në ndërtesën dhe

rrethinën e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike (tutje i njohur si – FIEK), në ndërtesën e të cilit është e vendosur KOSIX;

Neni 4

Tarifat për lidhje dhe shërbime të KOSIX

- 1) Anëtari i KOSIX-it është i obliguar që të paguaj tarifën e lidhjes në KOSIX në vlerë prej _____ € (_____ euro), në përputhje me dokumentin e tarifave për shërbimet e KOSIX-it, e miratuar në përputhje me nenin 4.8 të Rregullores e KOSIX-it, brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga data e lidhjes së kësaj Kontrate. Kjo tarifë është e pakthyeshme;
- 2) Anëtari i KOSIX-it është i obliguar që të paguajë një tarifë mujore pranë ART-së për ofrimin e shërbimeve të KOSIX-it, në përputhje me dokumentin e tarifave për shërbimet e KOSIX, e cila tarifë mund të ndryshoj në varësi të llojit të shërbimit të zgjedhur. Për llojin e shërbimit dhe ndryshimet në llojin e shërbimit, përfaqësuesi i anëtarit të KOSIX-it do të njoftojë me shkrim ART, më së voni 15 ditë para fillimit të periudhës së shfrytëzimit të shërbimeve të KOSIX-it;
- 3) Paguesa mujore duhet paguar në bazë të faturës së lëshuar nga ART për muajin respektiv, dhe duhet paguar me se voni deri me date 15 te muajit ne vijim;

Neni 5

Emërtimi i përfaqësuesve dhe Komunikimi

- 1) Anëtari i KOSIX-it duhet të emëroj përfaqësuesin dhe zëvendësin e tij në Grupin Punues Teknik (GP) në kuadër të KOSIX.
- 2) Përfaqësuesi i anëtarëve të KOSIX-it sipas paragrafit 1. të këtij neni është i autorizuar për të gjitha kontaktet zyrtare me KOSIX, duke përfshirë edhe definimin e nivelit të shërbimeve, të cilat anëtarët e KOSIX-it i përdorin. Komunikimet zyrtare me KOSIX-in bëhen në formë të shkruar ose përmes adresës elektronike info@kosix.net, të gjitha këto në përputhje me dispozitat e Rregullores.
- 3) Anëtarët e KOSIX-it e caktojnë adresën, e-mailin e tyre, për komunikim zyrtar me KOSIX, në përputhje me dispozitat e Rregullores.
- 4) Lista e personelit teknik të autorizuar nga anëtarët e KOSIX-it, të cilët kanë qasje në hapësirën e KOSIX-it, dhe përdorin pajisjet e anëtarëve të KOSIX-it mund të gjendet në shtojcën 1 të kësaj Kontrate dhe konsiderohet si pjesë integrale e kësaj Kontrate.

Neni 6

Azhurnimi i të dhënave

- 1) Anëtari i KOSIX-it obligohet që rregullisht të mbajë dhe azhurnojë të dhënat administrative që kanë të bëjnë me detyrimet nga neni 5 i kësaj Kontrate, si dhe të dhëna për lidhjen e Kontratës, për shkëmbim reciprok të trafikut të internetit me anëtarët tjerë të KOSIX-it.

Neni 7

Kohëzgjatja dhe Ndërprerja e Kontratës

- 1) Kjo Kontratë lidhet për një kohë të pacaktuar, deri në momentin e shkëputjes së Kontratës nga cilado palë në përputhje me nenin 7 të Rregullores.
- 2) Me rastin e ndërprerjes së Kontratës me kërkesë të anëtarit, kjo duhet të njoftoj në formë të shkruar më së voni 15 para ndërprerjes, përveç në rastet kur palët janë marr vesh ndryshe.
- 3) Nëse vjen deri te ndërprerja e Kontratës, për arsye të moskryerjes së obligimeve të marra nga ana e anëtarëve të KOSIX-it, për këtë rast zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Detyrimet.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 1) Palët kontraktuese bien dakord që për çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo Kontratë, të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mënyrë paqësore dhe në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Telekomunikacion, Rregullores për Zgjidhjen e Konflikteve si dhe me dispozitat e Rregullores dhe të kësaj Kontrate;
- 2) Gjyqet e Kosovës do të kenë juridiksion mbi konfliktet ndërmjet palëve të dala nga kjo Kontratë.

Neni 9

Dispozitat Finale

- 1) Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe, në dy (2) kopje valide origjinale.
- 2) Palët kontraktuese e kanë lexuar këtë Kontratë dhe Rregulloren e cila është bazë për lidhjen e kësaj Kontrate dhe në shenjë të pranimit e kanë nënshkruar këtë Kontratë dhe e kanë shpallur këtë të vlefshme me datën __/ __/ 2012.

Nr. i referencës së ART _____

Për ART

Për (emri i personit juridik)

(emri, mbiemri, thirrja)

Funksioni